



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E FINANCAVE/MINISTARSTVO ZA FINANSIJE
MINISTRY OF FINANCE

KB FR Kosovo Board on Standards for Financial Reporting
 BK RF Bordi Kosovar mbi Standardet per Raportim Financiar
 KB FI Kosovski Bord za Standarde Finansijskog Izvestavanja

SKK 11

Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit në valutë të huaj

Qëllimi

Ndërmarrja mund të ketë transaksione në valuta të huaja. Në mënyrë që t'i përfshijë transaksionet në valutë të huaj në pasqyrat financiare të ndërmarrjes, transaksionet duhet të shprehen në valutën raportuese të ndërmarrjes.

Çështjet kryesore në kontabilitet për transaksionet në valutë të huaj janë që të vendoset se cilat kurse të këmbimit do të përdoren dhe si të njihet efekti financiar të ndryshimeve në kurset e këmbimit në pasqyrat financiare.

Fushëveprimi

1. Ky standard duhet të përdoret në kontabilitet për transaksionet në valuta të huaja.
2. Ky standard nuk ka të bëjë me paraqitjen në Pasqyrën e rrjedhës së parave të gatshme që del nga transaksionet në valutë të huaj (shih SKK 8 "Pasqyrat e rrjedhës së parasë").

Përkufizimet

3. Shprehjet në vijim janë përdorur në këtë standard me këto kuptime të caktuara:

Valuta raportuese është valuta e përdorur në pasqyrat financiare.

Valutë e huaj është valuta tjetër nga valuta raportuese e ndërmarrjes.

Kursi i këmbimit është raporti i këmbimit të dy valutave.

Ndryshimi i këmbimit është ndryshimi që rezulton nga raportimi i numrit të njëjtë të njësisë të valutës së huaj në valutën raportuese në kurse të ndryshme të këmbimit.

Kursi përmbyllës është kursi i këmbimit momental në datën e pasqyrës së bilancit.

Zërat monetarë janë paratë e mbajtura si dhe pasuria e detyrimet që do të pranohen ose të paguhen në shuma të caktuara ose vlera të përcaktueshme të parasë.

Vlera fer është shuma për të cilën mund të këmbëhet një pasuri ose të përcaktohet përfundimisht një detyrim midis palëve të vetëdijshme dhe të vullnetshme në transaksionin “duarlibër”.

Transaksioni “duarlibër” është transaksioni midis palëve që nuk janë të ndërlidhura, me ç'rast secila vepron sipas interesit të vet personal.

Njohja fillestare e transaksioneve në valutë të huaj

4. Transaksioni në valutë të huaj është transaksioni, që emërtohet në valutë të huaj ose kërkon përlllogaritje në valutë të huaj, që përfshinë transaksionet që krijohen kur ndërmarrja:
- (a) blen ose shet mallra ose shërbime, çmimi i të cilave është i emërtuar në valutë të huaj.
 - (b) huazon ose krediton fonde, kur shumat e të pagueshmeve dhe të arkëtueshmeve janë të emërtuara në valutë të huaj.
 - (c) në të tjera raste, siguron ose tjetëron pasuri, ose nxjerr ose paguan detyrime, të emërtuara në valutë të huaj.

5. Transaksioni në valutë të huaj duhet të regjistrohet, me njohje fillestare në valutë raportuese, duke zbatuar në shumën e valutës së huaj kursin e këmbimit ndërmjet valutës raportuese dhe valutës së huaj në datën e transaksionit.
6. Kursi i këmbimit më datën e transaksionit shpesh referohet si kursi i atypëratyshëm. Për arsye praktike, kursi që i afrohet kursit aktual më datën e transaksionit përdoret shpesh, si për shembull, kursi mesatar për një javë ose një muaj mund të përdoret për të gjitha transaksionet për secilën valutë të huaj që ndodh gjatë asaj periudhe. Sidoqoftë, nëse kurset e këmbimit lëvizin shumë, përdorimi i kursit mesatar për një periudhë nuk është i besueshëm dhe duhet të përdoret kursi i këmbimit në datën e transaksionit.

Raportimi më datën pasuese të pasqyrës së bilancit

7. Në secilën datë të pasqyrës së bilancit:
 - (a) Zërat monetarë në valutë të huaj duhet të raportohen duke e përdorur kursin përmbyllës.
 - (b) Zërat jomonetarë që barten në aspekt të kostos historike të emërtuar në valutë të huaj, duhet të raportohen duke e përdorur kursin e këmbimit më datën e transaksionit.
 - (c) Zërat jomonetarë që barten në vlerën fer të emërtuar në valutë të huaj duhet të raportohen duke i përdorur kurset ekzistuese të këmbimit në kohën, kur janë përcaktuar vlerat.
8. Shuma e regjistruar e një zëri përcaktohet në pajtim me Standardet e Kontabilitetit të Kosovës. Për shembull, pasuritë e patundshme, impiantet dhe pajisjet mund të maten me koston historike ose me shumën e rivlerësuar duke u bazuar në vlerën fer. Pa marrë parasysh se si është përcaktuar shuma e regjistruar, duke u bazuar në koston historike apo në vlerën fer, shumat e këtilla të papërcaktuara për zërat e valutës së huaj pastaj raportohen në valutën raportuese në pajtim me këtë standard. Shumat e zërave në valutë të huaj të përcaktuara në këtë mënyrë pastaj raportohen në valutë raportuese në pajtim me këtë standard.

Njohja e ndryshimeve të këmbimit

9. Ndryshimet në këmbim mund të krijohen gjatë pagesës së zërave monetarë ose gjatë raportimit të zërave monetarë të një ndërmarrjeje me kurse të ndryshme nga ato me të cilat janë regjistruar fillimisht gjatë periudhës ose janë raportuara në pasqyrat financiare paraprake. Këto

ndryshime të këmbimit duhet të njihen si e ardhur ose si shpenzim në periudhën në të cilën ato krijohen.

10. Ndryshimi në këmbim rezulton, kur ekziston ndryshim në kursin e këmbimit ndërmjet datës së transaksionit dhe datës së pagesës së çdo zëri monetar të krijuar nga transaksioni në valutë të huaj. Kur transaksioni është paguar brenda periudhës së njejtë kontabël, sikur ajo në të cilën ka ndodhur, i gjithë ndryshimi në këmbim njihet në atë periudhë. Sidoqoftë, kur transaksioni paguhet në periudhën pasuese kontabël, ndryshimi i këmbimit i njohur në secilën periudhë intervenuese deri në periudhën përlogaritëse përcaktohet nga ndryshimet e këmbimit gjatë periudhës.

Efektet tatimore nga ndryshimet në këmbim

11. Fitimet dhe humbjet në transaksionet në valutë të huaj mund t'i kenë shoqëruar efektet tatimore, të cilat janë llogaritur në pajtim me SKK 12 "Tatimi mbi fitimin".

Shpalosja

12. Një ndërmarrje duhet ta shpalosë vlerën e ndryshimeve të këmbimit, të përfshirë në fitimin neto ose humbjen për periudhë.

Data e hyrjes në fuqi

13. Ky standard hyn në fuqi për raportet financiare në periudhën prej apo pas 1 janar 2002.